

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Projektligji për Dhomat e Specializuara, a mund ta çojë Kuvendin drejt një tjetër ngërçi politik?
ADRESA	https://albeu.com/kosove/projektligji-per-dhomat-e-specializuara-a-mund-ta-coje-kuvendin-drejt-nje-tjetere-ngerci-politik/1026732/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:24:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:21:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7218129a04adc0092c92e42ab38e05093ea6bfd5bb3630ca1ce7defc86ea643c
TEKSTI	f4b4525ad2c0ce52e432e76fc03e7471568dafe2f6d7b45bac0ae7d987fc28bf
PAMJA	c3a0baf4e47c5055db5b2b40c4d2bc92ff85d1e055ff1b782e56f8b45a26de29

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9fcb89542ce20160899ea15501fc7fa41778e544c28008229dfb88232e2e212c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9fcb89542ce20160899ea15501fc7fa41778e544c28008229dfb88232e2e212c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Projektligji për Dhomat e Specializuara, a mund ta çojë Kuvendin drejt një tjetër ngërçi politik?



Gjykata Kushtetuese ka publikuar të mërkurën vendimin lidhur me kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë.

Sipas Kushtetutes, institucionet janë krijuar në pajtim me Kushtetutën, ndërsa afati për zgjedhjen e presidentit është caktuar deri më 6 tetor.

Pas publikimit të këtij vendimi, PDK-ja ka kërkuar që Kuvendi të mbledhet sa më shpejt dhe Projektligji për Dhomat e Specializuara të vendoset si pika e parë e rendit të ditës.

Në reagimin e saj, kjo parti ka deklaruar se Kuvendi duhet të mbledhet menjëherë dhe të nisë punimet me shqyrtimin e Projektligjit për Dhomat e Specializuara.

Analistët politikë thonë se kjo kërkesë duhet të trajtohet me kujdes, veçanërisht për shkak të afateve të shkurtra që kanë mbetur për funksionalizimin e institucioneve.



të fundit /



Projektligji për Dhomat e Specializuara, a mund ta çojë Kuvendi...



Plagosja e të riut në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin...



Britania e tronditur nga vdekja e 12-vjeçares në Dorset: dyshohet se ...



Ademi bashkë me katër futbollistë të Kosovës nga breza të ndryshë...



Shpërthen një dron në veri të Gazës, humbin jetën dy ushtarë...



Zgjedhjet në Brazil përplasnin Uashingtonin/ 31 ligjvënës amerika...



Trump dhe Xi me ceremoni madhështore, por pa zgjidhje për...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium



Sipas tyre, nëse palët nuk arrijnë ta ndajnë debatin për Dhomat e Specializuara nga nevoja për funksionimin e institucioneve të Kosovës, mosmarrëveshjet për këtë projektligj mund të shkaktojnë një tjetër bllokadë politike.

Jakupi: Iniciativa e PDK-së për Dhomat e Specializuara është e vonuar, 13 ditë e ardhshme do të tregojnë gatishmërinë për kompromis

Analisti politik Zejnullah Jakupi ka thënë për "Bota sot" se kërkesa e PDK-së duhet parë në dritën e vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese dhe kohës së kufizuar për përmbylljen e proceseve institucionale.

Ai ka vlerësuar se është e kuptueshme që PDK-ja kërkon shqyrtim të shpejtë të nismës së saj, pasi këtë projektligj e ka paraqitur si çështje prioritare. Sipas Jakupit, propozimi parasheh ndryshime me rëndësi në juridiksionin e Dhomave të Specializuara, në ekzekutimin e dënimeve dhe në kompetenca të tjera, ndaj nuk bëhet fjalë për një çështje thjesht teknike apo procedurale.

Megjithatë, ai ka theksuar se fakti që PDK-ja e konsideron këtë projektligj prioritet nuk i obligon automatikisht partitë e tjera ta miratojnë atë në formën aktuale.

Projektligji, sipas tij, duhet të vlerësohet në raport me Kushtetutën, obligimet ndërkombëtare të Kosovës dhe bazën juridike mbi të cilën janë themeluar Dhomat e Specializuara. Për shkak të natyrës së ndërlikuar të këtyre çështjeve, edhe ekspertët juridikë kanë shprehur dilema rreth kufijve të ndryshimeve që mund të bëhen.

Jakupi ka paralajmëruar se kjo çështje mund të shndërrohet në shkak të një ngërçi të ri nëse vendoset si kusht për funksionimin e institucioneve.

Ai ka thënë se rreziku paraqitet në rast se debati për Dhomat e Specializuara kthehet në një kusht absolut për punën e Kuvendit. Sipas tij, partitë duhet të bëjnë dallimin mes të drejtës për ta shqyrtuar projektligjin dhe detyrimit për të garantuar funksionimin e institucioneve.

Nëse këto dy procese nuk ndahen, çdo mospajtim rreth përmbajtjes së projektligjit mund të ndikojë edhe në procedurat e tjera institucionale. Jakupi ka rikujtuar se, sipas PDK-së, kanë mbetur vetëm 13 ditë për përmbylljen e disa proceseve, përfshirë zgjedhjen e presidentit dhe shmangien e zgjedhjeve të parakohshme.

Sipas tij, shqetësimi kryesor është që kjo periudhë të shpenzohet në përplasje politike, në vend që të përdoret për arritjen e marrëveshjeve të nevojshme institucionale.

Jakupi ka vlerësuar se skenari më problematik nuk do të ishte vetëm mosmiratimi i një projektligji, por kalimi i 13 ditëve të mbetura pa marrëveshje për çështjet themelore institucionale. Një situatë e tillë, sipas tij, do ta kthente Kosovën në pasiguri politike dhe do të rrezikonte përfundimin e proceseve kushtetuese brenda afatit.

Ai ka bërë thirrje që debati për Dhomat e Specializuara të zhvillohet në Kuvend, mbi argumente juridike dhe politike, por pa e penguar funksionimin e institucioneve.

Edhe nëse partitë nuk pajtohen me tekstin e propozuar nga PDK-ja, Jakupi ka thënë se duhet të gjendet një mekanizëm politik për trajtimin e kësaj çështjeje, ndërsa paralelisht duhet të parandalohet krijimi i një ngërçi të ri institucional.

Analisti ka kritikuar edhe momentin kur PDK-ja e ka paraqitur këtë iniciativë, duke theksuar se funksionalizimi i institucioneve duhet të jetë prioritet.

Sipas tij, 13 ditët e ardhshme do të jenë provë për aftësinë e aktorëve politikë për të arritur kompromis. Çështjet e diskutueshme, ka thënë Jakupi, mund të vazhdojnë të debatohen, por funksionimi institucional duhet të mbahet i ndarë nga konflikti politik.

Jakupi e ka cilësuar të vonuar qëndrimin dhe nismën e PDK-së për këtë çështje. Ai ka ngritur pikëpyetje për faktin se kjo parti, as gjatë kohës kur Hashim Thaçi ishte në krye të saj dhe u miratua themelimi i Dhomave të Specializuara, e as sot përmes pasardhësve të tij politikë, nuk ka ndërtuar një kauzë të qartë dhe të qëndrueshme për këtë temë.

Ai ka thënë se në këtë fazë duhet të synohet funksionalizimi dhe konsolidimi i institucioneve të Kosovës, si dhe zgjidhja e ngërçit aktual politik. Nismat e tjera, sipas tij, mund të trajtohen më pas përmes institucioneve dhe procedurave kushtetuese e ligjore.

Jakupi ka përfunduar se nuk është në interes të vendit që një iniciativë e vonuar për Dhomat e Specializuara të shndërrohet në burim të një përplasjeje të re, në një periudhë kur Kosovës i nevojiten stabiliteti dhe funksionaliteti institucional.

Mehmeti: PDK-ja po e kushtëzon kërkesën për Dhomat e Specializuara, Kuvendi nuk duhet të bllokohet

Analisti politik Gani Mehmeti ka deklaruar për "Bota sot" se kërkesa e PDK-së që Projektligji për Dhomat e Specializuara të jetë pika e parë e rendit të ditës është e kushtëzuar.

Sipas tij, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese do të mjaftonte që çështja të përfshihej në rendin e ditës së Kuvendit, pa përcaktuar domosdoshmërisht se duhet të jetë pika e parë.

Mehmeti ka vlerësuar se kërkesa duhet të shqyrtohet dhe të diskutohet, pa u parapërcaktuar nëse duhet të miratohet apo jo ndryshimi i ligjit për Dhomat e Specializuara.

Ai ka thënë se paraqitja e një kërkesë në Kuvend nuk duhet të shihet si arsye për t'u zemëruar me partinë apo personat që e kanë ngritur atë. Sipas tij, kërkesa parashtrohet për t'u diskutuar dhe, nëse miratohet, kjo është në rregull, por edhe mosmiratimi i saj nuk duhet të ndikojë në trajtimin e çështjeve të tjera apo në funksionimin e Kuvendit.

Mehmeti ka theksuar se, kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme shtetërore dhe kërkesa ndërkombëtare, interesi i shtetit, vendit, atdheut dhe popullit duhet të jetë mbi interesat e individëve, pavarësisht rangut apo nivelit të tyre.



Ai ka nënvizuar se, edhe në rast se kërkesa e PDK-së në mbështetje të Projektligjit nuk miratohet, kjo parti duhet të vazhdojë bashkëpunimin me organet e Kuvendit dhe të mos lejojë pasojë në çështjet madhore të shtetit.

Megjithatë, duke u mbështetur në përvojën e tij me PDK-në, Mehmeti ka paralajmëruar se Kuvendi i Kosovës mund të përballlet me një tjetër ngërç, gjë që do të ishte shumë e dëmshme për vendin.

Ai ka thënë se ditët në vijim do të jenë vendimtare për arritjen e një marrëveshjeje politike dhe për funksionalizimin e institucioneve të Kosovës.

Sipas Mehmetit, skenari më shqetësues do të ishte që këto ditë të kalonin pa një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit dhe institucioneve të tjera të Kosovës.

Një dështim i tillë, ka paralajmëruar ai, do t'i shkaktonte Kosovës humbje të mëdha nga Bashkimi Europian, krahas pasojave të tjera që do të sillte mungesa e institucioneve.

Shtuar më 25.09.2026 10:21

Tags: KUVEND , partite , pdk , projektligj , Speciale , zgjedhje



Kush e emëroi Vlorë Hysenin?/ Berisha akuzon Ramën, Vuçiqin dhe Bato...



Sot nis gjykimi në mungesë i 53 të akuzuarve për Masakrën e Mejës



OVL-UÇK organizon protesta në Kosovë pas aktgjykimit të Speciales



Kryesia e Kuvendit mbledhet sot pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese





Kurti për fitoren e Kosovës ndaj Irlandës: "Dardanët" zhvilluan ndeshje të...



Të premtën mbledhet Kryesia e Kuvendit, partitë paralajmërojnë hapat e...



Familja dhe institucionet e Kosovës përkujtojnë Afrim Bunjakun në trevjetorin e...



Jo në emrin tim" i kërkon Kryesisë së Kuvendit të përfshijë në agjendë Ligji...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.